VENDIM
Nr.132, datë 22.10.2010

PËR HEQJEN E LICENCËS SË SUBJEKTIT RADIOFONIK PRIVAT VENDOR "RADIO TAKE 5"

Këshilli Kombëtar i Radios dhe Televizionit, i përbërë nga:

Endira	Bushati	Kryetare
Alban	Karapici	Zëvendëskryetar
Suela	Musta	Anëtare
Sami	Neza	Anëtar
Gent	Ibrahimi	Anëtar
Zylyftar	Bregu	Anëtar

Pasi mori në shqyrtim çështjen me:

Objekt: Heqje e licencës së subjektit radiofonik privat vendor "Radio Take 5".

Baza ligjore: neni 7 pika 21, neni 33 pika 3, neni 34, pika 4/a dhe neni 137/3, të ligjit nr.8410, datë 30.9.1998 "Për radion dhe televizionin publik e privat në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar dhe vendimi nr. 49, datë 28.7.2010 i KKRT-së "Mbi vlefshmërinë e licencës së radios vendore "Radio Take 5"".

VËREN SE:

Me vendimin nr. 49, datë 28.7.2010, KKRT-ja ka vendosur paraprakisht heqjen e licencës së subjektit radiofonik privat vendor "Radio Take 5". Sipas pikës dy të vendimit të sipërcituar, subjekti "Radio Take 5" kishte të drejtë që brenda një muaji të parashtronte pretendimet e tij lidhur me këtë vendim. Edhe pse ky afat ka kaluar, rezulton se ky subjekt nuk ka paraqitur asnjë pretendim apo ankesë në lidhje me vendimin nr.49, datë 28.7.2010 të KKRT-së.

Nga inspektimet e kryera në qytetin e Tiranës, nga specialistët e drejtorisë teknike në KKRT, ka rezultuar se ky operator radiofonik, për periudhën 16-mujore prill 2009-korrik 2010, nuk ka filluar transmetimin për të mbuluar me sinjal zonën e tij të licencimit. Në datën 20.5.2010, këtij operatori i është dërguar shkresa me nr.610 prot, ku i është kërkuar arsyeja e mosdaljes në transmetim. Deri tani, nga ana e subjektit nuk është depozituar asnjë përgjigje në KKRT.

Bazuar në ligjin nr.8410, datë 30.09.1998, të ndryshuar, neni 34, pika 4/a: "Këshilli Kombëtar i Radios dhe Televizionit ka të drejtë të heqë licencën e transmetimit kur: .. 4. Nuk ka filluar transmetimin pas hyrjes në fuqi të vendimit për dhënie licence për një periudhë kohe:

a) 180 ditë në transmetimet e radios vendore …"

Gjithashtu nga verifikimet e kryera në këtë qytet konstatohet se subjekti nuk ka studio dhe pikë transmetuese të sinjalit,

PËR KËTO ARSYE,

Këshilli Kombëtar i Radios dhe Televizionit, në bazë të nenit 7 pika 21, nenit 33 pika 3, nenit 34 pika 4/a dhe nenit 137/3, të ligjit nr.8410, datë 30.9.1998 "Për radion dhe televizionin publik e privat në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar,

VENDOSI:

1. T'i heqë licencën subjektit radiofonik privat vendor "Radio Take 5".
2. Licenca me nr. 076FML, bëhet e pavlefshme.

3. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në gjykatë brenda 30 ditësh nga marrja dijeni, në përputhje me Kodin e Procedurës Civile, kreu “Gjykimi i mosmarrëveshjeve administrative”.

4. Ngarkohet administrata e KKRT-së për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYETARE
Endira Bushati